




INFRASTRUCTURE :

- bicycle lanes
- pedestrian zones
- multimodal streets
- pram / elderly-friendly pavements
- pump tracks
- bike delivery / cargo solutions

- bicycle festivals
- car free days
- citizen workshops
- kids city days
- capacity building for public workers
- bike-to-work campaigns
- school / pre-school actions

That's
urban move



to human-friendly future cities



our core team

In addition to our core team we are part of a broader network of experts in the Balkans as well as in Switzerland which we use for exchange and cooperation.



Artan Morina

The Planner

Traffic planning, street design, elaboration and development of mobility strategies, urban planning and urban development is the world of Artan. When work gets complex, interdisciplinary and with a need for creative thinking – even better.

Project manager with technical and intercultural competencies acquired in Switzerland and Europe.

Studied urban planning and city planning in Switzerland.



Tobi Gessler

The Cyclist

Built a mountain bike tourism company in Albania, Kosovo and Macedonia, and is involved in various cycling projects (Critical Mass, Cikloficina, Bike Festival) in Tirana Albania. Previously managed a bike rental station together with refugees and delivered blood samples, flowers and court documents as a cycle messenger in Zurich / Switzerland. Has a Master in development studies.



Martin Lerch

The Pedestrian

Perceives the urban environment as a diversely layered organism, often with a surprising number of cross relations. Walks the streets and analyzes their usage, challenges and potentials.

Experienced architect and as such caring for the detail without losing sight of the bigger picture. Involvement in various private and public building projects in Switzerland, Albania and Kosovo.





"Bjeshka dhe Qyteti" – Projekti që e lidh Suharekën me të ardhmen

Të dashur qytetarë,

Unë besoj se Suhareka nuk ka pse të zgjedhë mes qytetit dhe natyrës, ne mund t'i kemi të dyja. Projekti **"Bjeshka dhe Qyteti"** është më shumë se një ide. Është rruga jonë drejt një Suhareke moderne, të gjallë dhe krenare për veten.

Çfarë do të bëjmë?

- Do ta lidhim qytetin me bjeshkët me **teleferik dhe shtigje moderne** – për ecje, biçikletë dhe turizëm gjithëvjetor.
- Do t'i japim jetë fshatrave malorë përmes **agroturizmit, bujtinave dhe prodhimeve lokale**.
- Do të krijojmë **vende pune** për të rinjtë, të rejat, për familjet që duan të rrinë dhe të jetojnë këtu.
- Do të sjellim **vizitorë, të ardhura dhe zhvillim pa betonizim e pa ndotje**.

Ky projekt ka për qëllim **jo vetëm turizmin, por edhe krenarinë, ekonominë dhe jetën e mirë** për të gjithë ne. Me këtë vizion te Ri, Suhareka do të jetë qyteti ku natyra, historia dhe njeriu ecin bashkë.

Ky është një premtim i realizueshëm. Nuk është utopi. Fondet ekzistojnë. Partnerët janë të gatshëm. Ne kemi nevojë vetëm për vullnet dhe besim.

Bjeshka dhe Qyteti – Vizion për Suharekën 2026/36

Qëllimi: Të krijojmë një lidhje të qëndrueshme dhe funksionale mes qytetit dhe bjeshkëve, përmes infrastrukturës së lehtë ekologjike që fuqizon turizmin, komunitetin dhe ekonominë lokale.

Transporti dhe Akses

1. **100 km rrjet shtigjesh malore:** Shtigje të përbashkëta për ecje, biçikletë dhe kalërim, me gjerësi 4–6m, të pajisura me sinjalistikë, ura druri, ndalesa dhe pika panoramike.
2. **Dy linja teleferiku (nga 5 km secila):** Lidhje direkte mes qytetit/fshatrave dhe majave panoramike si Antena dhe Guri i Dellocit, me kabina (dhuratë donacion) dhe stacione shërbimi.
3. **Rrjet i integruar:** Lidhje mes fshatrave, shtigjeve ekzistuese dhe transportit publik urban

Përdorimi dhe Potenciali

1. **Turizëm gjithëvjeter:** Aktivizim i zonave me potencial të lartë natyror dhe kulturor.
2. **Agroturizëm dhe ekonomi rurale:** Bashkëpunim me prodhues lokalë për promovimin e produkteve si mjalti, djathi, bimët e egra.
3. **Eksperiencë e plotë:** Qasje rekreative dhe edukative – nga hiking, paragliding dhe ecje panoramike, deri te workshop-e, ngjarje kulturore dhe kulinari vendore.

Zhvillimi dhe Implementimi

1. Faza paraprake:


- Studimi i fizibilitetit
- Konsultimi me komunitetin
- Projektimi urbanistik
- Sigurimi i financimit nga fondet IPA, EBRD, SECO, etj.

2. Faza zbatuese:

- Realizimi i infrastrukturës me partnerë vendorë dhe ndërkombëtarë.
- Rrjetëzim i shtigjeve me aplikacione digjitale dhe shenja informative.

Identiteti i Ri i Suharekës

Ky projekt nuk është thjesht investim në turizëm, por një filozofi zhvillimi që ndërthur historinë, natyrën dhe teknologjinë për të ndërtuar një destinacion unik në Rajon.




Suhareka 2026/36

Plani i Veprimit
dhe Vizioni

[illegible]



Skema





Strukture mundesish



Bicikleta dhe shtigje



Bus



Kuzhina, kurs kulinarik



Marsh, stigje marshimi



Kodrina, zona kodrinore



Bjeshke



Paragliding



Teleferik



Fshatra malore



Stacione



Tren



Tram



Galeri

**urban
move**



Bjeshka dhe Qyteti

Koncepti im



Lidhja e qytetit
me bjeshkën



Zhvillim i
transportit
ekologjik



Qendër turistike
dhe kulturore

Shtiget



Shtigjet e Rinisë



Shtigje për
Mountainbike



Shtigje për
Kua

Potenciali për zhvillim turistik – mobilitet dhe turizem malor i qendrushem

- **Linjat e teleferikut si nxites te turizmit te qendrushem**
 - Ndertimi i linjave te teleferikut per te lidhur fshatrat malore
 - Teleferiku ofron nje mjet transporti atraktiv dhe ekologjik per zonat e thella malore, duke krijuar nje atraksion te rendesishem turistik.
 - Vizitoret do te mund te eksplorojne zonen ne menyre te qendrushme dhe te vazhdojne udhetimin e tyre ne shtigjet malore te „High Scardus Trail“ qe kalon neper Kosove, Maqedoni dhe Shqiperi, deri ne Oher dhe Shen Naum.
- **Zhvillimi i rrjeteve te shtigjeve dhe turizmit aktiv**
 - Krijimi i shtigjeve te ecjes malore dhe lidhja mes tyre, duke ofruar mundesi per ture disa ditore
 - Shembull: zona qe lidh Suhareken me PZ permes maleve te Koxha Ballkanit, Pashallarise, Bjeshkeve te Budakoves, Shterpces dhe Lubotenit
- **Investime ne produkte dhe burime lokale**
 - Fuqizimi i kapaciteteve njerezore permes trajnimeve per guida, operatore, shkolla teknike dhe profesionale
 - Funksionalizimi i bujtinave tradicionale me fokus ne pervoja autentike dhe ofrimin e ushqimeve lokale

Potenciali për zhvillim turistik – mobilitet dhe turizem malor i qendrushem

- **Skijimi dhe sportet e bardha**
 - Shpatet e Sharrit ne pjesen e Suharekes, te orientuara nga veriu, verilindja dhe veriperendimi, ofrojne potencial te madh per sporte dimerore.
- **Rendesia e planifikimit strategjik**
 - Krijimi i ketij plani konceptual dhe i nje studimi te fizibilitetit te strukturuar mire eshte kyc per terheqjen e fondeve nderkombetare dhe zbatimin me sukses te ketij projekti
 - Nevojitet nje strategji promovimi per te pozicionuar zonen si destinacion i qendrueshem turistik.

- **Prioriteti kryesor – Mobiliteti i qëndrueshëm**
Hapi i parë është hartimi i një koncepti ideor, i domosdoshëm për sigurimin e fondeve nga agjencitë financiare për projekte të kësaj natyre.
- **Faza fillestare – Studim fizibiliteti për mobilitet të qëndrueshëm dhe ekologjik**
Transport i organizuar për turistët nga qyteti i Suharekës drejt pikave turistike malore, duke siguruar që ai të jetë:
 - i saktë në kohë,
 - i rehatshëm,
 - ekologjik dhe i qëndrueshëm.
- **Qëllimi:** Kjo zonë turistike të jetë e shfrytëzueshme gjatë gjithë vitit, jo vetëm në verë.

- **Linja e parë**
Lidhja ndërmjet qytetit të Suharekës dhe fshatrave malorë të Sharrit (si Budakova, Mushtishti etj.)
Opsionet e transportit: autobusë, teleferik, tren malor.
- **Linja e dytë**
Lidhja ndërmjet fshatrave me njëri-tjetrin.
Optimizimi i linjave ekzistuese të autobusëve (minibusë ekologjikë) si dhe krijimi i linjave të reja që shërbejnë për një itinerar (shteg) ideal turistik.
- **Linja e tretë**
Lidhja ndërmjet stacionit të autobusëve në Suharekë dhe pjesëve të tjera të qytetit.
Opsione të mundshme: tramvaj, integrim me linjën hekurudhore kryesore.
Synohet integrimi i projekteve lokale me ato qendrore për një sistem të bashkërenduar transporti.

- **Shtegu i parë:**
 - Lidhja mes qytetit dhe fshatrave bjeshkore te Grykes permes shtigjeve te bicikletave, ecje dhe kalerim (Suhareka - Biraqa – Stravucina – Mrizi – Dragaqina – Versheci – Qadraku – Grejqeci – Llanishti – Budakova – Antena,...)
- **Shtegu i dytë:**
 - Lidhja mes fshatrave bjeshkore Antena – Delloci – Maqiteva – Mushtishti – Grejkoci - Kabashi – Korisha – Pashallare – Prevalla,...)
- **Shtegu i tretë:**
 - Lidhja mes qytetit dhe fshatrave te Podrimes (Suhareka - Reshtani – Studencani – Doberdelani – Pagarusha – Bershanci – Peqani - Sllapuzhani – Duhel – Dragaqine Liqeni)

Projekti i fazes se pare ka për qëllim ndërtimin e një **rrjeti të integruar shtigjesh malore** me gjatësi prej rreth **30 km** dhe realizimin e një **linje teleferiku prej 5 km**, që lidh zonat e qendrës me lartësitë panoramike në jug-lindje të komunës. Infrastruktura do të shërbejë për ecje, biçikleta dhe kalërim, duke krijuar një përvojë gjithëpërfshirëse për vizitorët dhe banorët lokalë.

Objektivat kryesore të projektit:

- Promovimi i **turizmit malor të qëndrueshëm** në fshatrat Budakovë, Maqitevë, Mushtisht, Delloc, Greikoc.
- Zhvillimi i **mobilitetit alternativ miqësor me mjedisin**, përmes shtigjeve dhe teleferikut si mjet ekologjik lëvizjeje.
- Aktivizimi i **potencialit rural dhe bujqësor**, përmes ndalesave agroturistike dhe lidhjes me prodhues lokalë të bio produkteve.
- Edukimi dhe ndërgjegjësimi mbi natyrën përmes **pikave panoramike, tabelave informuese dhe hartave digjitale**.

Komponentet kryesore te projektit:

- **30 km shtigje multifunkSIONALE** (ecje, biçikleta, kalërim) me gjerësi 4–6m, të shtruar me zhavorr të ngjeshur dhe të pajisura me sinjalistikë, ura druri, pika pushimi dhe ndriçim në segmente të caktuara.
- **1 linjë teleferiku prej 5 km**, me kapacitet mesatar, e përbërë nga kabina (dhuratë) dhe dy stacione me nyje sanitare, pika vrojtimi, kioskë informative dhe ndalesa për pajisje ose ushqim.
- **Hartë turistike digjitale** që integrohet me rrjetin e shtigjeve dhe mundëson orientim, navigim dhe promovim të bujtinave, krojeve dhe pikave historike.



Perfitimet per Komunen:

- Rritje e vizitueshmërisë dhe e **turizmit të brendshëm dhe të jashtëm**.
- Mundësi për **zhvillim ekonomik lokal** përmes shërbimeve dhe agroturizmit.
- Kontribut në **ruajtjen e natyrës** dhe kontrollin e qasjes në zonat e ndjeshme.
- Promovim i **identitetit lokal dhe përfshirje e komunitetit** në mirëmbajtje dhe operim.

Zhvillimi dhe Menaxhimi

Akterët kryesorë

- Komuna e Suharekës
- Organizatat lokale të turizmit
- Ofrues privatë të kalërimit dhe qiradhënies me bicikleta
- Sipërmarrje që menaxhojnë teleferikë

Zhvillimi i
transportit të
qendrueshëm /
ekologjik



Hapat e Zbatimit

1. Studimi i fizibilitetit teknik dhe ekonomik
2. Hartimi i projektit urbanistik dhe arkitektonik
3. Konsultim me komunitetin lokal
4. Gjetja e financimit (IPA, donatore, PPP, etj)
5. Zbatimi

Zhvillimi i
transportit te
qendrueshem /
ekologjik



Plani Strategjik i Zhvillimit – Hekurudhat e Kosovës

Koncepti “Bjeshka dhe Qyteti”

Është në përputhje të plotë me strategjinë kombëtare të zhvillimit hekurudhor dhe ofron **sinergji të shumta** për integrimin e turizmit malor me qasjen e qëndrueshme të mobilitetit.


Koha është tani

Aktualisht janë të disponueshme **fonde të konsiderueshme për Ballkanin Perëndimor**, të dedikuara për projektet e gjelbra dhe **zhvillimin e qëndrueshëm** (sustainable development).



Suhareka 2026/36








Shtegu i pare
Shtigje 30km





Shtegu i pare
Teleferik 5 km






Karakteristikat e Shtegut te Pare:


1. **Përshkrimi:** Rruga ndjek formacionet malore-bjeshkore duke kaluar fshatra me nje gjatesi rreth 30km ne total. E shtruar me zhavorr te ngjeshur, me nje gjeresi rreth 4-6m, e ndare sipas nevojave te ecjes, bicikletave dhe kalerimit.
2. **Funksione:** aktivitete si ecje, hiking, kalerim, bicikleta malore. Pika ndalese si platforma vezhgimi, pushimore, mrize dhe burime uji.
3. **Potencial:** zhvillimi i agroturizmit, ekoturizmit, turizmit kulturor dhe vizitave edukative.
4. **Teleferiku:** pika e nisjese Vraniq, prane xhamise (akses nga rruga nacionale. Pika mberritese: Antena me nje lartesi mbi 1700m. Gjatesia e linjes se ketij teleferiku rreth 5km. Qellimi dhe perfitimet: transporti i shpejte dhe panoramik, Akses i drejteperdrejte ne destinacionet alpine dhe mundesia per ngjitje te lehte dhe zbritje permes shtigjeve natyrore.



Shtegu i dyte
Shtigje 30km



Shtegu i dyte
Teleferik 5km






Karakteristikat e Shtegut te Dyte:

1. **Përshkrimi:** Rruga ndjek formacionet malore-bjeshkore duke kaluar fshatra me nje gjatesi rreth 30km ne total. E shtruar me zhavorr te ngjeshur, me nje gjeresi rreth 4-6m, e ndare sipas nevojave te ecjes, bicikletave dhe kalerimit.
2. **Funksione:** aktivitete si ecje, hiking, kalerim, bicikleta malore. Pika ndalese si platforma vezhgimi, pushimore, mrize dhe burime uji.
3. **Potencial:** zhvillimi i agroturizmit, ekoturizmit, turizmit kulturor dhe vizitave edukative, tregues natyrore si burime, peme te rralla, rrenoja, kisheza, etj.
4. **Teleferiku:** pika e nisjeses Mushtisht, prane rruges nacionale (R118). Pika mberritese: Guri i Dellocit me nje lartesi mbi 1600m. Gjatesia e linjes se ketij teleferiku rreth 5km. Zgjedhja teknike e mundshme: Teleferik klasik (kabina te vogla te vazhdueshme) ose Funicular me dy vagona qe levizin ne te njejten linje. Qellimi dhe perfitimet: transporti i shpejte dhe panoramik, Aksesi i drejteperdrejte ne destinacionet alpine dhe mundesia per ngjitje te lehte dhe zbritje permes shtigjeve natyrore.



Shtegu i trete
Shtigje 30km



Karakteristikat e Shtegut te Trete:

1. **Përshkrimi:** Rruga ndjek formacionet kodrinoro - malore me pyje te shperndara dhe hapësira bujqesore duke kaluar fshatra me nje gjatesi rreth 30km ne total. E shtruar me zhavorr te ngjeshur, me nje gjeresi rreth 4-6m, e ndare sipas nevojave te ecjes, bicikletave dhe kalerimit.
2. **Funksione:** aktivitete si ecje, hiking, kalerim, bicikleta malore. Pika ndalese si platforma vezhgimi, pushimore, mrize dhe burime uji.
3. **Potencial:** zhvillimi i agroturizmit, ekoturizmit, vizita ne ferma, degustime lokale., kulture, kulinari dhe ecje rekreative.
4. **Vlera dhe perfitime:** aktivizimi i zonave qe aktualisht kane me pak qasje ekonomike, krijimi i nje rrjeti te mbyllur rrethor turistik qe lidhe te gjitha segmentet ne forme unaze (loop). Perdorim per aktivitete te kombinuara.

Sot:



Neser:





Sot:



Neser:




Projekte
Strategjike 2026/36








Neser:





Aktivitetet e propozuara – Zona e Sharrit

- **Jo ndërtim hotelesh të reja**, por përdorimi i **shtëpive ekzistuese** si bujtina turistike (shtëpi prej guri ose druri).
- **Pika shitjeje për djathin** dhe produkte të tjera lokale, me **shërbime kulinarike dhe ushqime tradicionale**.
- Organizimi i **kampeve shkollore verore dhe dimërore**.
- **Zhvillim i agroturizmit** përmes integritit të bujqësisë dhe turizmit rural.
- **Krijimi i një platforme rajonale si lloj Airbnb/Booking** për promovimin e akomodimit autentik lokal. Funksionim përmes Komunes dhe në bashkëpunim me bujtinat ku një shumë solide derdhet në fondin komunal për mirëmbajtjen e këtij shtegu.
- **Zhvillimi i brandit “Bjeshka dhe Qyteti”** si identitet rajonal.
- Krijimin/ndertimin e një qendre rehabilituese sportive si pushimore për sportistët për përgatitje
- **Ruajtja e emërtimeve të origjinës** për produkte të veçanta (p.sh. **Qeni i Sharrit**, djathi, lule të egra – *Crocus scardus*, gështenja, mjalti, boronica), në përputhje me **Marrëveshjen e Lisbonës**.
- **Zgjerimi i markës** përtej “Djathit të Sharrit” dhe „Qenit të Sharrit“ për të përfshirë edhe produkte të tjera unike të zonës. Raca e Nishorit, lopa bushe, dhite e kuqe, etj etj.
- **Klinikë natyrore** për ofrimin e shërbimeve shëndetësore dhe kurative për turistët, me fokus në **ajrin e pastër dhe klimën e shëndetshme të Sharrit**.





Aktivitetet e propozuara në zonën e Sharrit

- **Shtegtim, mobilitet dhe sinjalistikë** nëpër shtigje malore (Trail High Scardus)
- **Pista dhe gara biçikletash**
- **Ture biçikletash** përgjatë të gjithë zonës së bjeshkëve të Sharrit
- **Paragliding**
- **Ngjitje (hiking)** në natyrë të egër
- **Kurse dhe ture kulinarie për tërë familjen**
- **Takime, ngjarje dhe workshope** për kompani dhe grupe të ndryshme
- **Evente sociale dhe private:** festa, dasma, ahengje, organizime biznesi
- **Zip Line**
- **Rrjetëzim dhe sinjalizim i shtigjeve ekzistuese**, me publikim në platforma digjitale ose aplikacione mobile
- **Ndërtim shtigjesh për ciklizëm malor (downhill)**
- **Hapja e pikave të reja për paragliding (exit points të certifikuara)**
- **Marshim dhe ecje rekreative**
- **Jogging në shtigje të dedikuara**
- **Seanca Yoga në natyrë**
- **Aktivitete kulturore:** poezi, lexim publik, shfaqje artistike





Render



Render



Render





Render





Render







Render





Render





Referenca dhe
shembuj

Zvicerr





Komponenti	Kosto (€)
Terren + zhavorr	600,000 – 900,000
Ura druri	150,000 – 300,000
Sinjalistikë + mbrojtje	90,000 – 180,000
Pika pushimi	30,000 – 60,000
Zona të pjerrëta	30,000 – 60,000
TOTALI	900,000 – 1.5 milionë EUR

Kosto per shtegun
Totali orientues
per 30km shteg

Kosto per shtegun
Totali orientues
per 30km shteg

1. Përgatitje terreni dhe shtresë zhavorri

- Ekskavim, nivelim, drenazh, tampon, zhavorr kompakt
- Kosto: 20,000 – 30,000 EUR/km
→ 600,000 – 900,000 EUR

2. Ura druri (të vogla deri në 10-30m)

- Supozojmë 10–15 ura të shpërndara në 30 km
- Mesatarisht 15,000 – 25,000 EUR/urë
→ 150,000 – 300,000 EUR

3. Sinjalistikë, orientim, mbrojtje (railing në skaje, në zona të ekspozuara)

- Shtylla, tabela, mbrojtëse druri
- 3,000 – 6,000 EUR/km
→ 90,000 – 180,000 EUR

4. Stola, pika pushimi, mbrojtje dielli/shiut (çati të vogla druri)

- Supozojmë çdo 2 km një pikë pushimi = 15 pika
- 2,000 – 4,000 EUR/pikë
→ 30,000 – 60,000 EUR

5. Punime shtesë në zona më të pjerrëta (rampa, mbrojtje ndaj erozionit, gjerësi ekstra)

- Opsionale, për 20% të gjatësisë
- 5,000 – 10,000 EUR/km
→ 30,000 – 60,000 EUR

Për një teleferik prej 5 km, me kapacitet mesatar (turistik dhe gjysmë-urban), kostoja në Kosovë ose rajon (Ballkani) varet nga shumë faktorë, por mund të bëjmë një përlllogaritje realiste orientuese.

 Parametrat e projektit:

- Gjatësia: 5 km
- Kapacitet mesatar: ~500–1000 persona/orë (në të dy drejtimet)
- Tipologjia: Gondola me shumë kabina (jo kabinë e vetme), për 6–10 persona secila
- Stacione: minimum 2 (nisje dhe mbërritje), shpesh 1 ndërmjetëse nëse është shumë e gjatë
- Terren kodrinor/malor (siç është rasti në Kosovë)

 Kosto orientuese në rajon për këtë lloj teleferiku:

Komponenti	Përshkrimi	Kosto e përafërt
Infrastruktura lineare	Shtylla, kabllo çeliku, themele	2 milionë EUR/km
Stacionet	Ndërtim, mekanikë, pajisje hyrëse/dalëse	1.5 – 2.5 milionë EUR total
Kabinat (30–50 njësi)	Me 6–10 vende secila	0 EUR (donacion)
Komandimi & energjia	Elektrike, monitorim, sistem sigurie	0.5 – 0.6 milionë EUR
TOTAL ORIENTUES		9.5 – 10.5 milionë EUR

 Shembuj krahasues:

- Brezovica (propozim teleferiku): 2.5–3 milionë EUR/km
- Valbona (Alpet Shqiptare, planifikim i pezulluar): 3.5 milionë/km
- Zlatibor, Serbi: 9 km teleferik me 55 kabina → 25 milionë EUR (~2.7 milionë/km)

Kosto per teleferik



Strukturë e Sugjeruar Financimi për Projektin “Shtigje dhe Teleferik”

Kosto totale e projektit:

11 – 12 milionë EUR

Objektivi financiar i realizueshëm për vetëfinancim/grante:

8 – 10 milionë EUR

Kosto per
1 shteg 30km dhe
1 teleferik 5km

Mesazh për qytetarët:

Banorët e Suharekës dhe diaspora do të kenë mundësinë ta përdorin shtegun dhe teleferikun me një pagesë simbolike prej **1 €**. Vizitorët nga qytetet e tjera dhe jashtë vendit do të paguajnë më shumë, ndërsa të ardhurat anësore (kioska, evente, sponsorizime) do të mbulojnë pjesën tjetër të mirëmbajtjes.

Investimi prej **10–12 milion €** kthehet për rreth **6 vite**, vetëm nga të ardhurat direkte të biletave dhe shërbimeve. Por ndikimi i tij është shumë më i madh: rreth **10 mijë familje** që vizitojnë shtegun dhe teleferikun shpenzojnë gjithashtu për ushqim, pije dhe aktivitete të tjera. **Këto para mbeten në Suharekë** – në restorante, bujtina dhe biznese lokale – duke gjeneruar të ardhura të reja dhe duke hapur vende pune. Ky projekt nuk është vetëm një investim që kthehet, por një motor i fuqishëm për gjallërimin ekonomik dhe social të Komunës.

- **12 milion € investim, 6 vite kthim. Fitimi për Suharekën nis që ditën e parë.**
- **Shtegu dhe Teleferiku kthejnë investimin për 6 vite, por gjallërojnë Komunen tone menjëherë.**

Analiza e kosto-
kthimit për fazën
e parë (30km
shtigje dhe 1
teleferik prej 5km)




Si ta bëjmë realitet?

- **Partnerë të gatshëm për të mbështetur investimin**
 - **Banka, institucione dhe agjenci financimi** janë të interesuara për realizimin e këtyre ideve, sidomos në aspektin e **transportit të qëndrueshëm dhe ekologjik**
- **Për të pasur më shumë mundësi**, ju nevojiten **profesionistë të përkushtuar**, të gatshëm të marrin përgjegjësi dhe të udhëheqin zhvillimin
- **Ne si Urban Move mund t'ju ndihmojmë dhe t'ju mbështesim në mënyrë profesionale**, duke sjellë përvojën tonë në konceptim, planifikim dhe implementim të projekteve të qëndrueshme

Si ta bëjme realitet
ne Mandatin e
Pare Administrativ
2026 - 2030

Gjetja e fondeve per Projektin e Detajuar apo/edhe Zbatimin?

- Fonde nderkombetare agjensione perkrahin projekte te tilla qe jane te beshme (feasible):
 - Instrument Pre Accession IPA
 - Regional Sustainable Development
 - Green Agenda
 - Environment Protection
 - Regional Development of Tourism
 - EBRD
 - KfW
 - SECO
 - World Bank
 - UNDP
 - GIZ



Hapat e duhur


Konsulencë dhe përkrahje nga Zvicra dhe Ballkani

- Transferimi i njohurive (**know-how**) në bashkëpunim me inxhinierët dhe të rinjtë lokalë
- Organizimi i buxhetit dhe sigurimi i **fondeve financiare**
- Përfshirja e **planifikuesve dhe inxhinierëve** me përvojë
- **Staf bashkëpunues vendor** dhe i angazhuar
 - Seminare profesionale për **aktorët lokalë**
 - Zhvillim sipas modelit më të mirë (“**best case**”) për të gjithë vendin
 - Këshilla profesionale përmes **ekspertëve tanë lokalë dhe nga Zvicra**
 - Këshillim për **formësimin dhe realizimin e idesë / konceptit**
 - Seanca **brainstorming**, punëtori dhe plane veprimi konkrete

- Janë ndërtuar shtigje për ecje, shtigje për biçikleta dhe rrugë ngjitjeje.
- Rruga është shumë interesante për adhuruesit e ecjes dhe canyoning-ut.
- Në fshat mund të shihen një urë harkore prej guri nga shekulli XII dhe një xhami e ndërtuar shumë kohë më parë.
- Rruga fillon nga qendra e fshatit dhe shtrihet për 600 metra në një rrugë të asfaltuar. Pastaj vazhdon një rrugë e paasfaltuar prej 2 kilometrash deri te shtëpia e fundit e fshatit. Prej aty fillon një shteg ecjeje prej 300 metrash që kalon nëpër pyll dhe të çon te ujëvara e parë 17 metra e lartë. Gjatë rrugës duhet të kalosh një përroskë të vogël.

Referenca dhe
shembuj

Gjeorgji



- Rishikimi i studimit ekzistues dhe zbatim i masave prane linjave hekurudhore
- Lidhje te sigurta per bicikleta dhe mbyllje te boshlleqeve ne rrjet
- Hartim dhe vleresim i varianteve te mundshme
- Percaktim i gjurmes dhe nyjeve lidhese
- Projektim miqesor per bicikleta, perfshire nenkalimet
- Koordinim me komunat, pronaret dhe institucionet publike



Referenca dhe
shembuj

Zvicerr

- 20 kilometra rrugë e shpejtë për biçikleta
- Studim fizibiliteti (Bern – Thun)
- Riorganizimi i kryqëzimeve dhe segmenteve
- Ndarja e rruges nga trafiku i makinave
- Zgjerim dhe asfaltim i gjurmës
- Heqje stacioneve që nuk përmbushin standardet
- Përshtatje e gjeometrisë dhe sinjalistikës për përparësi të biçikletave



Referenca dhe
shembuj

Zvicerr

- Arrosticini: mish deleje ne shkopinj, i pjekur ne zgate.
- Maccheroni alla chitarra: Pastë tradicionale e prerë me veglën "chitarra", shërbehet me salcë mishi ose domatesh.
- Porchetta: Mish derri i mbushur me barishte dhe hudhër,.
- Pecorino d'Abruzzo: Djathë deleje me shije të fortë, përdoret si antipastë ose me bukë dhe verë.
- Sagne e ceci: Makaronë shtëpie me qiqra, hudhër dhe vaj ulliri – vakt i ngopshëm dhe tradicional.
- Confetti di Sulmona: Bajame me sheqer, të njohura në festa dhe dasma.
- Montepulciano d'Abruzzo: Verë e kuqe nga rrushi Montepulciano, me trup të plotë dhe shije të pasur.



Referenca dhe
shembuj

Itali. Tradita
ushqimore nga
Abruzzo

- Asparagu nga Giulianova: shijen e butë dhe teksturë delikate. Përdoret në kuzhinën lokale dhe eksportohet në pjesë të tjera të Italisë.
- Zafferano dell'Aquila (Shafrani nga L'Aquila): Shafrani nga L'Aquila është i famshëm për cilësinë dhe shijen e tij të fortë. Rajoni malor i L'Aquillas ofron kushte ideale për kultivimin e tij. Përdoret në risoto, pasta dhe ëmbëlsira.
- Pecorino di Farindola: Një variant i veçantë i djathit pecorino, prodhuar nga qumështi i deles dhe i pjekur në shpella në qytetin Farindola.
- Fagiolo di Lamon: Fasule me teksture te bute. Përdoret ne supa dhe gatime tradicionale.
- Mandorle di Toritto: Bajame me shije unike, perdoren ne receta te embla dhe te kripura.



Referenca dhe
shembuj

Itali, produkte
lokale nga Abruzzo

- Speci i Pontecorvo: Një lloj speci nga qyteti Pontecorvo në Molise, i njohur për shijen e tij të butë dhe teksturën krokante.
- Domatja e San Nicola: Një varietet domatesh i kultivuar në qytetin San Nicola në Molise, i dallueshëm për shijen e ëmbël dhe ngjyrën e kuqe intensive.
- Kungulli i Serinos: Një lloj i veçantë kungulli nga qyteti Serino në Molise, me formë të zgjatur dhe teksturë të butë.
- Angjinari i Monteneros: Një lloj angjinari i vogël nga rajoni Montenero në Molise, me shije të fortë dhe karakteristike.
- Pjepri i Riccias: Një lloj pjepëri i njohur për tulin e tij të lëngshëm dhe shijen e ëmbël..



Referenca dhe
shembuj

Itali, varietete
autoktone nga
Molise

- Projekt zhvillimi turistik gjithëvjetor ne Alpet zvicrrane, nisur nga investitore privat
- Perfshine: 6 hotele luksoze, 500 apartamente, fusha golfi, 40 km pista skijimi dhe 2 ´000 vende parkimi
- Kosto: rreth 2 Miliard €
- Synon turizem te qendrueshem, zhvillim ekonomik dhe permiresim infrastrukture
- Projekti filloi ne 2005, perfundon ne 2030
- Sot: destinacion i njohur boterisht per ski, golf dhe natyre



Referenca dhe
shembuj

Zvicerr



«Vizioni im për Suharekën e së Ardhmes»

Unë nuk po kandidoj për t'u bërë thjeshtë një kryetar tjetër. Po kandidoj për të ndërtuar një epokë të re për Suharekën, një qytet që ecën përpara pa harruar rrënjët. Që rritet pa e humbur frymën njerëzore. Që jeton në harmoni me natyrën, dhe jo kundër saj. Ideja ime është e qartë: “Bjeshka dhe Qyteti” është më shumë se një projekt. Është një filozofi zhvillimi, është një lidhje simbolike dhe reale mes njerëzve tanë, maleve tona dhe të ardhmes sonë. Ne kemi pasuri të jashtëzakonshme, natyrë të paprekur, histori, punëtorë dhe një rini të etur për jetë më të mirë. A nuk është koha që t'i lidhim këto potenciale me një vizion konkret? Me këtë koncept, unë angazhohem për:

- Lidhjen e qytetit me bjeshkën përmes një teleferikeve moderne, që sjell turistë, zhvillim dhe krenari.*
- Një rrjet të ri transporti ekologjik pa ndotje, që lidh çdo fshat me qytetin.*
- Ndërtimin e Suharekës si qendër turistike dhe kulturore, ku çdo qytetar ndjehet pjesë dhe përfiton.*

Ky nuk është një premtim elektoral – është një mision. E di që do të ketë skeptikë, por unë kam vullnetin, planin dhe partnerët për ta bërë realitet. Unë dua të jem ai lider që nesër do të kujtohet si njeriu që e ktheu Suharekën në një qytet model për Kosovën dhe më gjerë. Një vend ku qyteti dhe bjeshka bashkëjetojnë. Një vend ku jeta është më e mirë për të gjithë.

Voto për vizion. Voto për guxim. Voto për Suharekën që meriton më shumë.

Narrativa politike e konceptit «Bjeshka dhe Qyteti»



Në vend që të shkoja në det për pushime, ndoqa një rrugë që me çoi në një vend të pazbuluar, Suhareka dhe Bjeshkët përreth saj.

Nga Prizreni me tren, pastaj me një linjë tjetër malore drejt një bujtine mikpritese në bjeshkë.

Biciklete me qira, ecje, peshkim, ushqim lokal, njerez te ngrohte – gjithçka për të eksploruar natyrën.

Zgjedha të bëja një xhiro me mountainbike rreth 30 km. Gjatë rrugës takova banorë që më ofruan raki të bërë vetë, djathë shtëpie dhe tregime për vendin. Kur lodhesha, pushoja në hijen e lisave, derisa në fund zgjedha të ngjitem me teleferik për të parë perëndimin nga lart nga vendi i quajtur Antena dhe Guri i Dellocit.

Të nesërmen u ktheva në qytet dhe me transport publik mbërrita sërish në Prizren, gati për fluturim. Por zemra më mbeti lart, në bjeshkët që nuk i kisha njohur më parë.

Kartolina nga
Suhareka

Një mundësi për të gjithë zonen

Kjo histori mund të jetë realitet për shumë vizitorë. Suhareka ka gjithçka që i duhet një destinacioni të qëndrueshëm: amfiteater natyror, njerëz të mirë, histori, ushqim, klimë dhe potencial të pashfrytëzuar. Mjafton një vizion që t'ia lidh të gjitha.